

VENDIM
Nr. 176, datë 4.11.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“STAVEC”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 6520 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2 germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 116/5 prot., datë 29.10.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 976 prot., datë 16.7.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 143, datë 28.8.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në medien e shkruar me shkresën nr. 62/26 prot., datë 28.8.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., me shkresën nr. me nr. 976/1 prot., datë 2.9.2020, shoqëria ka përcjellë në ERE plotësim të pjesshëm të aplikimit të saj. Ndërsa me shkresën nr. 976/2 prot., datë 8.9.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në rastin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., nga llogaritja e afateve rezultoi se shoqëria ka humbur 12 vjet nga periudha e koncesionit e dhënë në vitin 2008 dhe si e tillë licenca do të jepet për periudhën e mbetur të koncesionit, për 23 vjet.

- Shoqërisë iu kërkua edhe dërgimi i një informacioni, në lidhje me zhvillimet e këtij projekti përgjatë periudhës nga nënshkrimi i kontratës së koncesionit deri në aplikimin në ERE.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 976/4 prot., datë 18.9.2020, ka përcjellë kryesisht dokumentacionin e munguar, por duke qenë se u konstatua sërish mungesë, ERE iu drejtua në rrugë elektronike (*email*), me shkresën nr. 976/5 prot., datë 15.10.2020, duke i kërkuar plotësimin e tyre.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 976/6 prot., datë 20.10.2020, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. është shoqëri koncesionare e themeluar si detyrim i kontratës së koncesionit dhe është regjistruar pranë QKB-së në datën 27.6.2008, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për qendrën kombëtare të biznesit” (QKB) me statusin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Kontrata nr. 809 rep., nr. 140 kol., datë 17.4.2008, “Kontratë koncesioni e formës BOT (ndërtim–operim–transferim) për ndërtimin e hidrocentralit ‘Stavec’”, e lidhur midis METE (sot MIE) dhe koncesionarit “Koka” sh.p.k., ka një afat 35-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- Referuar kontratës nr. 809 rep., nr. 140 kol., datë 17.4.2008, HEC “Stavec” ka një kapacitet prej 6000 kw dhe prodhim energjie rreth 25 620 000 kwh.

- Shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. ka paraqitur:

- Kontrata nr. 809 rep., nr. 140 kol., datë 17.4.2008, “Kontratë koncesioni e formës BOT (ndërtim–operim–transferim) për ndërtimin e hidrocentralit Stavec”, e lidhur midis METE (sot MIE) dhe koncesionarit “Koka” sh.p.k.

- Kontratë shtesë koncesioni me nr. 893 rep., nr. 765 kol., datë 25.8.2014, për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim–operim–transferim) për ndërtimin e HEC “Stavec”.

- Kontratë shtesë koncesioni me nr. 675 rep., nr. 224 kol., datë 6.7.2017, për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim–operim–transferim) për ndërtimin e HEC “Stavec”, e ndryshuar.

- Kontratë shtesë koncesioni me nr. 2203 rep., nr. 150/3 kol., datë 18.10.2018, për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim–operim–transferim), për ndërtimin e hidrocentralit “Stavec”, të ndryshuar.

- Shoqëria ka depozituar në ERE raportin e oponencës teknike të projektit:

- Raportin e oponencës teknike me nr. 429 prot., datë 16.4.2007, të kryer nga AKBN-ja për projektin e HEC “Stavec”.

- Raportin e oponencës teknike nr. 301/1 prot., datë 17.11.2010, mbi projektin e zbatimit të HEC “Stavec”, e cila rezulton të jetë hartuar gati dy vjet pas nënshkrimit të kontratës së koncesionit. Ky raport i OT-së është kryer nga Instituti i Ndërtimit/departamenti i oponencave, rregullave teknike dhe standardeve/MIE. Grupi i OT-së konkludon se projekti i zbatimit të HEC “Stavec”, ashtu siç është paraqitur nga grupi i projektimit, plotëson kushtet për zbatimin e tij.

- Raportin e oponencës teknike të AKBN-së me nr. 35131 prot., datë 23.11.2015, të miratuar nga autoriteti kontraktues, ku AKBN-ja shpreh që ndryshimet, sipas projektit të zbatimit të pasqyrohen në kontratë shtesë koncesioni.

- Shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. ka përcjellë në ERE miratimin e pikës së lidhjes për HEC “Stavec”, me nr. 12546/3 prot., datë 19.12.2019, të lëshuar nga OSHEE sh.a.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 976/1 prot., datë 2.9.2020, ka paraqitur lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor, me nr. 05/1 prot., datë 10.8.2020, miratuar me vendim të Këshillit të basenit ujqor Mat nr. 13 prot., datë 7.8.2020, dhënë për subjektin “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., shoqëria ka përcjellë në ERE “Leje mjedisore me nr. 289/11 prot., datë 10.7.2013, me nr. 16 vendimi dhe nr. identifikimi 1318, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për shoqërinë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., për ndërtimin dhe funksionimin e hidrocentralit me vendndodhje në Rrethin Bulqizë, qarku Dibër.

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim (neni 9, pika 1, germet “a”, “b”, “c”): plotësuar.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”): plotësuar.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germet “a”, “b”, “c”, “d”): plotësuar.

- Dokumentacionin teknik për HEC-in (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germet “a”, “b”, “c”, “d”) dhe pika 4.1.4, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”): plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera (neni 9, pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”): plotësuar.
Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stavec”, me kapacitet të instaluar 6520 kw, për një afat 23-vjeçar.

2. Shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. të bëjë me dije ERE-n mbi ecurinë e procesit të aplikimit për rinovim në çdo rast aplikimi, si dhe të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, jo më vonë se 1 muaj pas rinovimit të tyre.

3. Me plotësimin e afatit dhe të kushteve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti